



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 dhjetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Mëhershme të
W01453-shit sipas Rregullës 143(2)(c)**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave
Simon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21 dhe 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 137, 138(1) dhe 143(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Midis 4 dhe 7 nëntorit 2024, W01453 ("dëshmitari") dëshmoi në këtë proces.¹
2. Më 11 nëntor 2024, në përputhje me urdhrin e Trupit Gjykues,² Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi një kërkesë për pranimin e deklaratave të mëhershme të W01453-it sipas rregullës 143(2)(c) ("Kërkesa").³
3. Më 13 nëntor 2024, ekipet e Mbrojtjes të z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi ("Mbrojtja") dorëzuan përgjigje të përbashkët ndaj Kërkesës ("Përgjigja").⁴

II. PARASHTRIMET

4. ZPS-ja kërkon pranimin, për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre dhe për vlerësimin e besueshmërisë, të deklaratave të mëhershme, apo pjesëve të tyre, të renditura në Kërkesë ("deklaratat e mëhershme të W01453-shit"),⁵ të cilat ZPS-ja i diskutoi me W01453-shin gjatë marrjes së tij në pyetje prej saj, pas autorizimit nga

¹ Transkripti i Seancës, 4-7 nëntor 2024, f. 21733, rreshti 13, deri në f. 22274, rreshti 7.

² Transkripti i Seancës, 7 nëntor 2024, f. 22153, rreshtat 14-20.

³ F02708, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Mëhershme të W01453-shit sipas Rregullës 143(2)(c)*, 11 nëntor 2024, me Shtojcën 1.

⁴ F02716, Mbrojtja, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Mëhershme të W01453-it sipas Rregullës 143(2)(c)*, 13 nëntor 2024.

⁵ Deklaratat e mëhershme të W01453-it përfshijnë deklaratën për TPNJ-në të vitit 2003, dëshminë në TPNJ të vitit 2005, deklaratën për TPNJ-në të vitit 2001, dëshminë të TPNJ të vitit 2002 dhe intervistën me PSRK-në të vitit 2011. *Shih* Shtojcën 1 të Kërkesës.

Trupi Gjykes sipas rregullës 143(2).⁶ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se dy prej këtyre deklaratave të mëhershme (deklarata për TPNJ-në e vitit 2003 dhe dëshmia në TPNJ e vitit 2005) duhet të pranohen të plota duke pasur parasysh përmendjen gjerësisht të tyre gjatë marrjes në pyetje nga ZPS-ja, dhe nevojën që të shqyrtohen në kontekstin e tyre të plotë në lidhje me dëshminë e W01453-it në këtë çështje gjyqësore.⁷ Në lidhje me tri deklarata të tjera të mëhershme (deklaratën për TPNJ-në të vitit 2001, dëshminë në TPNJ të vitit 2002 dhe intervistën me PSRK-së të vitit 2011), ZPS-ja paraqet për pranim vetëm ekstraktet e përdorura me W01453-shin, duke qenë se diskutoi relativisht më pak ekstrakte me W01453-in gjatë marrjes në pyetje prej saj dhe duke pasur parasysh se ekstraktet që nuk janë paraqitur për pranim nga këto deklarata përgjithësisht trajtojnë aspekte me relevancë të kufizuar për çështjen aktuale.⁸ Deklaratat e mëhershme të W01453-it janë relevante dhe autentike, kanë vlerë provuese dhe pranimi i tyre nuk do të cenonte në mënyrë të papërligjur të akuzuarin.⁹

5. Mbrojtja kundërshton pranimin në tërësi të deklaratës për TPNJ-në të vitit 2003 dhe dëshmisë në TPNJ të vitit 2005.¹⁰ Mbrojtja argumenton se, për shkak të mospërputhjeve thelbësore mes tyre, deklarata për TPNJ-në e vitit 2003 dhe dëshmia në TPNJ e vitit 2005 nuk mund të jenë që të dyja të vërteta, dhe në çdo rast nuk mund të pranohen në tërësi, pasi vetëm pjesët që u diskutuan me Dëshmitarin në seancë mund të paraqiten nëpërmjet rregullës 143(2)(c).¹¹ Mbrojtja pretendon se, për shkak të këtyre mospërputhjeve thelbësore, nuk është etike që ZPS-ja të paraqesë që të dyja deklaratat e mëhershme për vërtetësinë e përmbajtjes

⁶ Kërkesa, para. 1, që i referohet Shtojcës 1 të Kërkesës. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 15. *Shih gjithashtu* Transkriptin e Seancës, 6 nëntor 2024, f. 22051, rreshti 20 deri në f. 22053, rreshti 23, f. 22054, rreshti 21 deri në f. 22055, rreshti 17, f. 22058, rreshti 21 deri në f. 22061, rreshti 3.

⁷ Kërkesa, para. 6. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 8.

⁸ Kërkesa, para. 10.

⁹ Kërkesa, para. 2, 5, 11. *Shih gjithashtu* Kërkesën, para. 12-14.

¹⁰ Përgjigjja, para. 2, 30. *Shih gjithashtu* Transkriptin e Seancës, 6 nëntor 2024, f. 22054, rreshtat 1-2, f. 22056, rreshti 4 deri në f. 22058, rreshti 19, f. 22061, rreshti 14 deri në f. 22062, rreshti 18.

¹¹ Përgjigjja, para. 14-15. *Shih gjithashtu* Transkriptin e Seancës, 6 nëntor 2024, f. 22064, rreshtat 3-7.

së tyre, dhe duhet të identifikojë se cilat dëshmi duhet të dorëzohen për vërtetësinë e përmbajtjes, dhe cilat për besueshmëri.¹² Sipas Mbrojtjes, vlera provuese e kufizuar e deklaratës për TPNJ-në të vitit 2003 dhe dëshmisë në TPNJ të vitit 2005 zhbëhet nga efekti dëmtues i tyre.¹³ Si alternativë, Mbrojtja parashtron se, në rast se Trupi Gjykses priret të pranojë deklaratën për TPNJ-në të vitit 2003 dhe dëshminë në TPNJ të vitit 2005 në tërësi, faqet të cilat nuk u pranuan nga Trupi Gjykses kur u paraqitën nga ZPS-ja nëpërmjet rregullës 154 (“faqet”) nuk duhen pranuar as sipas rregullës 143, duke marrë parasysh mungesën e vlerës provuese të tyre.¹⁴ Mbrojtja nuk kundërshton pranimin e pjesëve të deklaratave të mëhershme të W01453-shit që u lexuan si pjesë e procesverbalit gjatë marrjes në pyetje nga pala thirrëse, por kundërshton pranimin për vërtetësinë e përmbajtjes të pjesëve të dëshmisë në TPNJ të vitit 2005 që nuk janë në përputhje me deklaratën për TPNJ-në të vitit 2003.¹⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Dispozitat ligjore përkatëse në lidhje me pranimin e provave sipas rregullave 138 dhe 143 janë shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëparshme të lëshuara nga Trupi Gjykses.¹⁶

¹² Përgjigja, para. 2, 16-23. *Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 25-28.*

¹³ Përgjigja, para. 24.

¹⁴ Përgjigja, para. 29, që i referohet F02117, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të W01453-shit, W03878-ës, W04446-ës, W04575-ës, dhe W04651-shit sipas Rregullës 154 (F02005) (“Vendimi sipas Rregullës 154”), 12 shkurt 2024, konfidencial, para. 14, poshtëshënimi 27, para. 25, poshtëshënimi 50 (versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë, F02117/RED).*

¹⁵ Përgjigja, para. 3, 30.

¹⁶ *Shih F01821, Trupi Gjykses, Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Deklaratave të Dëshmitarit W03827 sipas Rregullës 143(2) dhe Kërkesën e Mbrojtjes për Rishikim, 28 shtator 2023, para. 17-18; F01409, Trupi Gjykses, Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore, 31 mars 2023, konfidencial, para. 8-13. Shih gjithashtu F02130, Trupi Gjykses, Vendim mbi Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me Përdorimin e Deklaratave Të Mëhershme Mospërputhëse sipas Rregullës 143(2), 15 shkurt 2024, para. 22(b).*

IV. DISKUTIM

7. Fillimisht, Trupi Gjykses do të trajtojë argumentin e Mbrojtjes se vetëm ato pjesë të deklaratës për TPNJ-në të vitit 2003 dhe dëshmisë në TPNJ të vitit 2005 që u diskutuan me dëshmitarin në seancë gjyqësore mund të paraqiten nëpërmjet rregullës 143(2)(c).¹⁷ Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se nuk ka bazë ligjore në rregullën 143(2)(c) që t'i kërkojë palës thirrëse t'i lexojë një dëshmitari të gjithë deklaratën e mëhershme në mënyrë që Trupi Gjykses ta pranojë atë në tërësi.¹⁸ Trupi Gjykses është i mendimit se pranimi në tërësi i deklaratave të mëhershme, kur ato diskutohen gjerësisht me dëshmitarin, siç janë deklarata për TPNJ-në e vitit 2003 dhe dëshmia në TPNJ e vitit 2005, është i përshtatshëm, pasi i lejon Trupit Gjykses të vlerësojë deklaratat e mëhershme të dëshmitarit në kontekstin e duhur. Rrjedhimisht, argumenti i Mbrojtjes rrëzohet. Më tej, Trupi Gjykses vëren se, pas pranimit, mund të mbështetet në cilëndo pjesë apo nënpjesë të deklaratës së pranuar, të diskutuar shprehimisht apo jo me dëshmitarin. Megjithatë, fakti nëse dëshmitarit i është bërë pyetje mbi aspekte specifike të një deklarate të mëhershme ndikon në peshën që Trupi Gjykses mund të jetë i gatshëm t'i japë asaj pjese të deklaratës.

8. Sa i takon relevancës së deklaratave të mëhershme të W01453-shit, Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar tashmë se deklarata për TPNJ-në e vitit 2003 dhe dëshmia në TPNJ e vitit 2005 janë relevante për akuzat në Aktakuzë.¹⁹ Trupi Gjykses vë në dukje më tutje se, gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit prej saj, ZPS-ja i përdori deklaratat e mëhershme të W01453-shit për të ballafaquar W01453-shin me mospërputhjet e pretenduara dhe ndryshimet në përshkrimet e tij për rrethana të ndryshme, duke i dhënë një mundësi të drejtë për të komentuar, shpjeguar, apo mohuar çdo mospërputhje të pretenduar mes deklaratave të tij të

¹⁷ *Shih* Përgjigjen, para. 14-15.

¹⁸ F01903, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranim të Materialeve të Përdorura Gjatë Marrjes në Pyetje të W04746-ës*, 3 nëntor 2023, para. 22.

¹⁹ Vendimi sipas Rregullës 154, para. 12. *Shih gjithashtu* Vendimin sipas Rregullës 154, para. 25.

mëhershme dhe dëshmisë së tij në gjyq.²⁰ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se deklaratat e mëhershme të W01453-shit janë relevante për procesin si për informacionin që përmbajnë ashtu edhe si provë relevante për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarit.

9. Sa i takon autenticitetit dhe vlerës provuese *prima facie* të deklaratave të mëhershme të W01453-it, Trupi Gjykses rikujton se ka konstatuar tashmë se deklarata për TPNJ-në e vitit 2003 dhe dëshmia në TPNJ e vitit 2005, përfshirë faqet, përmbajnë tregues të shumtë të autenticitetit dhe mbështetshmërisë.²¹ Ndaj, Trupi Gjykses arriti në përfundimin se, me përjashtim të disa aspekteve tek faqet, të cilat ZPS-ja u udhëzua t'i trajtonte *viva voce*,²² deklarata për TPNJ-në e vitit 2003 dhe dëshmia në TPNJ e vitit 2005 ishin autentike dhe me vlerë provuese *prima facie*.²³ Trupi Gjykses mban parasysh parashtrimin e Mbrojtjes se mospërputhjet serioze tek Deklarata për TPNJ-në e vitit 2003 dhe Dëshmia në TPNJ e vitit 2005, përfshirë ato tek Faqet, nuk i lejojnë ZPS-së që të paraqesë që të dyja deklaratat sipas rregullës 143(2)(c) për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre, pa specifikuar se cilat nga pjesët janë të vërteta apo me mospërputhje.²⁴ Trupi Gjykses është bindur se ZPS-ja i ka dhënë Mbrojtjes informacion të mjaftueshëm dhe në kohë mbi provat që do të merren prej dëshmitarit,²⁵ përfshirë ato nga deklarata për TPNJ-në e vitit

²⁰ *Shih p.sh.* Transkriptin e Seancës, 4 nëntor 2024, f. 21822, rreshti 16 deri në f. 21826, rreshti 22, f. 21839, rreshti 10 deri në f. 21854, rreshti 19; Transkriptin e Seancës, 5 nëntor 2024, f. 21926, rreshti 13 deri në f. 21927, rreshti 20; Transkriptin e Seancës, 6 nëntor 2024, f. 22019, rreshtat 6-18, f. 22022, rreshti 16 deri në f. 22024, rreshti 3, f. 22035, rreshti 19 deri në f. 22036, rreshti 11. Trupi Gjykses vëren se, pas diskutimit të deklaratave të mëhershme, W01453 konfirmoi disa nga ato, por kryesisht hodhi poshtë përmbajtjen e tyre. *Shih p.sh.* Transkriptin e Seancës, 4 nëntor 2024, f. 21839, rreshti 10 deri në f. 21847, rreshti 5; Transkripti i Seancës, 5 nëntor 2024, f. 21879, rreshti 22 deri në f. 21887, rreshti 21, f. 21923, rreshti 13 deri në f. 21926, rreshti 12.

²¹ Vendimi sipas Rregullës 154, para. 13.

²² Vendimi sipas Rregullës 154, para. 14.

²³ Vendimi sipas Rregullës 154, para. 16, 25.

²⁴ Përgjigjja, para. 2, 16-23. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 25-28.

²⁵ F01594/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit nga Prokuroria të Listës së Përditësuar të Dëshmitarëve dhe Versionit më pak të Redaktuar të Dosjes Paraprake*, 9 qershor 2023, konfidenciale, f. 87-88; F01594/A03, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit nga Prokuroria të Listës së Përditësuar të Dëshmitarëve dhe Versionit më pak të Redaktuar të Dosjes Paraprake*, 9 qershor 2023, para. 65, 92, 112, 168-

2003 dhe dëshmia në TPNJ e vitit 2005.²⁶ Gjithashtu, Trupi Gjykses është bindur se pyetjet e ZPS-së ndaj W01453-shit mbi deklaratën për TPNJ-në të vitit 2003 dhe dëshminë në TPNJ të vitit 2005, përfshirë faqet, ishin mjaftueshëm të hollësishme për t'i mundësuar Trupit Gjykses që të vlerësonte mospërputhjet tek to dhe përcaktonte në kohën e duhur se cilat pjesë të pranojë si të vërteta. Gjithashtu, Mbrojtjes iu ofrua mundësi e plotë dhe e drejtë për të shqyrtuar këto aspekte me dëshmitarin, duke qenë se ato vlerësohen si relevante për vlerën provuese të atyre provave.

10. Në lidhje me argumentin e Mbrojtjes se deklarata për TPNJ-në e vitit 2003 dhe dëshmia në TPNJ e vitit 2005 nuk mund të jenë që të dyja të vërteta,²⁷ Trupi Gjykses rikujton se rregulla 143(2)(c), e cila trajton shprehimisht pranimin e deklaratave të mëhershme mospërputhëse, duke ofruar versione konkurren të së vërtetës, e ngarkon Trupin Gjykses me detyrën që të vlerësojë se cilin të zgjedhë nga këto versione. Kur konfirmoi kushtetutshmërinë e procedurës së përcaktuar në rregullën 143(2)(c), Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese deklaroi:

Për aq sa ndryshimet e rregullës 143(2)(c) kanë të bëjnë me mundësinë që një panel të pranojë si provë një deklaratë të mëhershme mospërputhëse, GJEDNJ-ja e ka bërë të qartë se për shpalljen e një të akuzuari fajtor, një gjykatë mund të përdorë deklaratat që ka dhënë një dëshmitar gjatë fazës hetimore dhe të cilat i ka tërhequr më pas në gjykim, me kusht që mbrojtja të ketë pasur mundësinë t'i bëjë pyetje atij dëshmitari në gjykim. Në të vërtetë, nuk mund të nxirret përfundim abstrakt se çdo herë duhet mbështetur në dëshminë e një dëshmitari të dhënë në gjykim dhe nën betim kundrejt një deklarate të po atij dëshmitari të dhënë gjatë procedimit penal, madje edhe kur këto të dyja janë kundërthënëse. Është paneli ai që duhet të vlerësojë besueshmërinë e dëshmitarit dhe të bëjë zgjedhjen midis dy versioneve konkurren të së

171, 173-176, 240-250, 260, 267, 310, 366, 481, 519-535 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 3 prill 2023, F01415/A01).

²⁶ F02005, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Provave nga W01453, W03878, W04446, W04575 dhe W04651 sipas Rregullës 154*, 14 dhjetor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-5, konfidenciale, para. 3-7 (versioni i redaktuar publik u dorëzua po të njëjtën ditë, F02005/RED).

²⁷ Përgjigjja, para. 14-15. *Shih gjithashtu* Transkriptin e Seancës, 6 nëntor 2024, f. 22064, rreshtat 3-7.

vërtetës, me kusht që të jetë respektuar standardi kushtetues i gjyimit të drejtë.²⁸

11. Për rrjedhojë, i takon Trupit Gjykses që në një fazë të mëvonshme të vlerësojë besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në deklaratat e tij në kuadër të tërësisë së provave që i janë paraqitur gjatë gjyimit, në përputhje me rregullën 139(2), dhe në bazë të argumenteve që përmbajnë dosjet e palëve. E rëndësishme është që Trupi Gjykses të ketë të gjithë informacionin relevant para se të vlerësojë besueshmërinë e dëshmitarit dhe mbështetshmërinë në provat e tij.²⁹ Trupi Gjykses është bindur se pranimi i të dyja deklaratave do t'i mundësojë ta bëjë atë vlerësim dhe do të ndihmojë në përcaktimin e të vërtetës për këtë rast.

12. Duke iu rikthyer deklaratës së TPNJ-së të vitit 2001, dëshmisë në TPNJ të vitit 2002, dhe intervistës me PSRK-së të vitit 2011, ekstraktet e të cilave u diskutuan me dëshmitarin gjatë dëshmisë, Trupi Gjykses është bindur se ato përmbajnë tregues të shumtë të autenticitetit dhe mbështetshmërisë, ndër të cilat: (i) ato janë prezantuar në formatet zyrtare të TPNJ-së apo PSRK-së, dhe transkriptet e dëshmisë në TPNJ janë gjithashtu të audio/videoincizuar; (ii) datat e deklaratave apo dëshmime dhe identifikimet e pjesëmarrësve në to janë të qarta; (iii) ato përmbajnë të dhënat personale të dëshmitarit; (iv) dëshmitari ka pasur detyrimin për të treguar të vërtetën; dhe (v) dëshmitari konfirmoi se kishte treguar të vërtetën në deklaratat dhe dëshminë e tij.³⁰ Trupi Gjykses vëren gjithashtu se Mbrojtja nuk kundërshton pranimin për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre për pjesët e deklaratës së vitit 2001, dëshmisë në TPNJ të vitit 2002 dhe intervistës me PSRK-në të vitit 2011 që u lexuan si pjesë e procesverbalit gjatë marrjes në pyetje të

²⁸ KSC-CC-PR-2020-09, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, para. 80; që i referohet ECtHR, *Camilleri v. Malta*, no. 51760/99, 16 May 2000; *Bosti v. Italy (dec.)*, no. 43952/09, 13 nëntor 2014, para. 35-47; *Berardi and Others v. San Marino (dec.)*, nos. 24705/16, 24818/16 and 33893/16, 1 June 2017, para. 73-79.

²⁹ *Shih* Vendimin sipas Rregullës 154, para. 15.

³⁰ *Shih* Kërkesën, para. 12-14, poshtëshënimet 25-28, 30-32, që i referohet pjesëve relevante të deklaratës për TPNJ-në të vitit 2001, dëshmisë në TPNJ të vitit 2002, intervistës me PSRK-së të vitit 2011 dhe dëshmisë së W01453-it në këtë proces.

W01453-it nga pala thirrëse.³¹

13. Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykses konstaton se deklaratat e mëhershme të W01453-it, përfshirë faqet, janë autentike dhe me vlerë provuese *prima facie*. Së fundi, për vlerësimin e ndonjë efekti të mundshëm dëmtues Trupi Gjykses ka marrë gjithashtu parasysh se: (i) pasi ZPS-ja paraqiti deklaratat e mëhershme të W01453-shit dhe Trupi Gjykses i shënoi për evidentim, Trupi Gjykses sugjeroi që, gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit prej saj, Mbrojtja duhet të marrë parasysh pranimin e secilës prej tyre;³² dhe se (ii) Mbrojtja i përdori dhe iu referua gjerësisht deklaratave të mëhershme të W01453-it gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit prej saj.³³ Trupi Gjykses është i mendimit se Mbrojtjes i është dhënë mundësi e bollshme për të kundërshtuar deklaratat e mëhershme të W01453-shit dhe për të kundërshtuar pjesët e deklaratave që konsideroheshin problematike. Për më tepër, Mbrojtja do ketë mundësi të plotë të bëjë parashtrime para Trupit Gjykses në lidhje me peshën që u duhet dhënë deklaratave të mëhershme të W01453-shit në rast se do të zgjedhë të bëjë një kërkesë sipas rregullës 130, dhe përsëri në dosjet përfundimtare, në qoftë se Trupi Gjykses do të vendosë të mos i hedhë poshtë të gjitha akuzat sipas rregullës 130. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se vlera provuese e deklaratave të mëhershme të W01453-it nuk zhbëhet nga efekti i tyre dëmtues.

14. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se deklaratat e mëhershme të W01453-shit janë të pranueshme sipas rregullave 138(1) dhe 143(2).

³¹ *Shih* Përgjigjen, para. 3, 30.

³² Transkripti i Seancës, 6 nëntor 2024, f. 22064, rreshti 24 deri në f. 22065, rreshti 2.

³³ *Shih p.sh.* Transkriptin e Seancës, 6 nëntor 2024, f. 22074, rreshti 10 deri në f. 22075, rreshti 11, f. 22078, rreshti 23 deri në f. 22084, rreshti 11, f. 22085, rreshtat 8-16, f. 22086, rreshti 21 deri në f. 22098, rreshti 12, f. 22109, rreshti 21 deri në f. 22110, rreshti 13, f. 22113, rreshti 22 deri në f. 22115, rreshti 1, f. 22116, rreshti 6 deri në f. 22119, rreshti 5; Transkriptin e Seancës, 7 nëntor 2024, f. 22176, rreshti 13 deri në f. 22178, rreshti 1, f. 22183, rreshti 1 deri në f. 22184, rreshti 25, f. 22186, rreshti 18 deri në f. 22189, rreshti 8, f. 22190, rreshti 14 deri në f. 22191, rreshti 16.

V. VENDIM

15. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON** Kërkesën;
- b) **PRANON** si prova deklaratat e mëhershme të W01453-shit identifikuar në Shtojcën 1 të Kërkesës; dhe
- c) **URDHËRON Administratoren** të caktojë për deklaratat e mëhershme të W01453-shit: (i) numra të provave materiale; dhe (ii) klasifikimin e shënuar në Shtojcën 1 të Kërkesës.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 16 dhjetor 2024

Hagë, Holandë.